

VENDIM
Nr. 4, datë 6.1.2025

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2443/6 prot., datë 30.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Desla’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2443 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 269, datë 10.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 11.12.2024 dhe 12.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2443/3 prot., datë 13.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2443/4 prot., datë 26.12.2024 dhe 2443/5 prot., datë 27.12.2024.

- Nga analizimi i aplikimit, në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar, në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; në pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; në pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të

konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti